

**QYTETI I SHKUPIT
SEKTORI PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK LOKAL
SHKUP**

**SHTOJCA E APLIKIMIT
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR REALIZIMIN E MANIFESTIMIT:
“FESTIVALI RITMI I ÇARSHISË”**

**PËRMBAJTJET, KUSHTET DHE KRITERET QË DUHET TË PËRMBUSHEN NGA ANA E
REALIZUESIT TË FESTIVALIT “Festivali Ritmi i Çarshisë”**

1. PËRMBAJTJET E FESTIVALIT

Manifestimi pritet të jetë destinacion për promovimin e pasurisë autentike kulturore që gjendet në çdo dyqan të vogël të Çarshisë, e cila është djepi i multikulturalizmit, ku ruhen dhe promovohen tradita, ushqimi, zakonet dhe punimet artizanale të mjeshtërive të vjetër dhe të rinj, të shoqëruara me program të pasur muzikor dhe me paraqitje të shoqërive kulturo-artistike, grupeve folklorike, muzikantëve solo dhe interpretuesve nga të gjitha bashkësitë etnike (maqedonase, shqiptare, vllahe, boshnjake, turke, rome etj.).

- Pritet të ofrojë listë bashkëpunimi dhe ftesash për pjesëmarrje të shoqatave ose shoqërive kulturo-artistike nga të gjitha bashkësitë etnike;
- Pritet të ftojë që të jenë pjesë e këtij manifestimi interpretues të njohur vendorë (solo), shoqëri kulturo-artistike dhe grupe muzikore, shoqata, startup-e, sipërmarrës dhe artizanë;
- Të ofrojë projekt-koncept të shkurtër për zhvillimin e manifestimit kushtuar Çarshisë, zejeve dhe multikulturalizmit;
- Të ftojë artizanë, piktorë dhe artistë kreativë që do të ekspozojnë dhe shesin produktet e tyre;
- Të sigurojë tenda / shtande përfaqësuese për prezantimin e ushqimit dhe pijeve, si dhe stola dhe tavolina për vizitorët;
- Të organizojë ceremoninë e hapjes së manifestimit nga ana e Kryetarit të Qytetit të Shkupit;
- Të dërgojë ftesa për prezantues të tjerë të gastronomisë (restorante, piceri kafene tradicionale, subjekte hotelierike etj.) sipas përzgjedhjes së realizuesit të projektit;
- Të bëjë pastrimin e lokacionit dhe kthimin e tij në gjendjen e mëparshme, siç ka qenë para përdorimit të tij.

2. KUSHTET E REALIZIMIT TË MANIFESTIMIT:

- Përvojë në organizimin dhe koordinimin e manifestimeve dhe festivaleve me karakter të hapur më se paku 5 vjet;
- Koha e mbajtjes – në konsultim me Qytetin e Shkupit;
- Lokacioni: Lokacioni adekuat për organizim në/para Çarshisë së vjetër të Shkupit;
- Infrastruktura: në marrëveshje me Qytetin e Shkupit;
 - rrethimi i hapësirës ku do të zhvillohet manifestimi,
 - sigurimi dhe lidhja e instalimit elektrik,
 - sigurimi i sistemit adekuat të zërimit dhe ndriçimit sipas lokacionit dhe objekteve,
 - sigurimi dhe lidhja e instalimit të ujësjellësit,
 - organizatori i ngjarjes, në bashkëpunim me Sektorin për zhvillim ekonomik lokal dhe Sektorin për punë komunale të Qytetit të Shkupit, të sigurojë pastrimin e lokacionit ku do të mbahet manifestimi para dhe pas përfundimit të tij (në bashkëpunim me NP “Higjiena komunale” të Qytetit të Shkupit);
 - sigurimi i nyjeve sanitare të lëvizshme për ruajtjen e higjienës gjatë manifestimit (marrëveshje me një kompani përkatëse);
 - sigurimi i numrit të përshtatshëm të tualeteve të lëvizshme (toitoi) sipas numrit të pritur të mysafirëve;
 - sigurimi i çadrave/shatorëve reprezentativë për shitje, shtëpizave, sporteleve, tavolinave dhe bankave për vizitorët;
 - sigurimi i animacionit aktiv dhe të përshtatshëm gjatë manifestimit sipas programit të manifestimit (projekt-koncept i shkurtër me ide);
 - posedimi i pajisjeve përkatëse logjistike për realizimin e manifestimit;
 - sigurimi i pajisjeve të përshtatshme muzikore për realizimin e programit muzikor të manifestimit (kontratë ose marrëveshje paraprake me kompani për pajisjet përkatëse);
 - skenë e madhe ku do të prezantohen grupe muzikore vendore dhe të huaja. Në skenë, si dhe në hyrje të lokacionit, të vendoset në vend të dukshëm logoja e Qytetit të Shkupit;
 - elemente të tjera infrastrukturore të cilat do të propozohen nga realizuesi dhe ekspozuesit;
- Informimi i shërbimeve të sigurisë për ngjarjen (në marrëveshje me Qytetin e Shkupit dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme);
- Angazhimi i një agjencie për ruajtjen e rendit publik në lokacionin e ngjarjes;
- Përgatitja e materialeve reprezentative dhe promovuese;
- Mbulimi mediatik i manifestimit, si nga mediat elektronike ashtu edhe nga ato të shkruara (një javë para ngjarjes të mbahet konferencë për media për informimin e publikut, pjesëmarrje në emisione, publikim i informatave në rrjetet sociale, radiostacione dhe gazeta elektronike);
- Sigurimi i një propozimi grafik-konceptual për materialet promovuese të manifestimit (poster, fletushkë, broshurë, pllakë mirënjohjeje, certifikatë falënderimi);

- Mbajtja e një evidence të veçantë të dokumenteve për të ardhurat dhe shpenzimet lidhur me organizimin e manifestimit, e cila pas përfundimit të manifestimit do t'i dorëzohet Qytetit.

3. KRITERET PËR LIDHJEN E KONTRATËS PAS THIRRJES PUBLIKE

Për bartësin e Kontratës në lidhje me Thirrjen publike do të zgjidhet ai aplikim që do të vlerësohet si më e favorshme nga totali i pikëve për secilin element veç e veç.

Kriteriume	Maksimum pikët
1. Struktura organizative dhe resurse	30
1.1 Aplikanti ka strukturën e nevojshme organizative dhe burimet njerëzore për realizimin e manifestimit (punonjës, vullnetarë aktivë, individë të angazhuar me kontratë, etj).	10
1.2 Aplikanti disponon me logjistikë (hapësirë zyre dhe pajisje teknike për realizimin e manifestimit).	10
1.3 Dukshmëria e aplikantit online	10
2. Financimi i propozim projektit për realizimin e manifestimit	30
2.1 Plani financiar i detajuar për mjetet e nevojshme për realizimin e manifestimit.	10
2.2 Aplikanti siguron një përqindje të pjesëmarrjes së tij në realizimin e projektit.	10
2.3 Plan financiar real (përshkrimi i shpenzimeve sipas pozicioneve të kategorive përkon me çmimet e tregut).	10
3. Kualiteti i propozim projektit për realizimin e manifestimit	40
3.1 Qëllimi i përgjithshëm i qartë dhe i përcaktuar i propozim projektit, i cili do të sjellë realizimin e prioriteteve të dhëna.	10
3.2 Zgjidhje cilësore dhe inovative të ofruara në projektin e propozuar.	10
3.3 Sigurimi i përfshirjes së institucioneve dhe organizatave të tjera.	10
3.4 Projekti i propozuar për realizimin e manifestimit është i qartë dhe i realizueshëm.	10

*Çdo fushë e kriterëve të veçanta do të vlerësohet me 1 pikë, 5 pikë ose 10 pikë, me kuptimin e mëposhtëm: 1 - jo, 5 - pjesërisht, dhe 10 - po.

*Shënim:

- Në projekt-propozimin e dorëzuar duhet të paraqitet lista e kantinave të verës të cilat do të marrin pjesë në manifestim;
- Duhet të dorëzohet pëlqim i nënshkruar për paraqitjen e interesit për pjesëmarrje në manifestim, veçmas për secilën kantinë vere dhe objekt hotelerie;
- Duhet të paraqitet përvoja e aplikuesit në organizimin e manifestimeve (gjatë vlerësimit do të merret parasysh organizimi i manifestimeve të llojit të ngjashëm, sa i përket masivitetit të manifestimit, kohëzgjatjes etj.);
- Në projekt-propozimin e dorëzuar duhet të përfshihet programi argëtues (emrat e artistëve muzikorë dhe të ngjashme);
- Duhet të dorëzohen biografite e organizatorëve të manifestimit.

Përgatiti: Rukije Asani

Kontrolloi: Marina Misajleski

Miratoi: Marina Misajleski

KRYETARI I QYTETIT TË SHKUPIT
Orce Gjorgjievski
